



**REPUBLIK E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN sha**

Nr. _____ Prot

Elbasan, më 18.06.2024

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

[18. 06. 2024]

Drejtuar: A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP SHPK

Procedura e prokurimit/lotit: "Procedurë e hapur – mallra"

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-04821-05-14-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Blerje materiale hidraulike"

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: 20. 05. 2024 Nr. 26

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. POWER INDUSTRIES shpk

L51706022H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **34 085 363** (tridhjetë e katër milionë e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) Lekë **pa TVSH.**

2. A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP shpk

L72230026K

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **32 956 616** (tridhjetë e dy milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) Lekë, **pa TVSH.**

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. POWER INDUSTRIES shpk

Emri i plotë i shoqërisë

L51706022H

Numri i NIPT-t

Për arsyet e mëposhtme:

- “OE, - “POWER INDUSTRIES” shpk, me NIPT: L51706022H,

a) Nuk përmbush:

“2.3.4 Operatorët Ekonomik në momentin e hapjes së ofertave, duhet të paraqesin nga një mostër për çdo tip produkti, sipas tabelës së mostrave të kërkuara nga AK, në shtojca 5 e DST.

Dorëzimi i mostrave, të bëhet pranë Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sha

Data e dorëzimit të mostrave të jetë data dhe ore e hapjes së ofertave. Mostrat e dorëzuara jashtë këtij afati, nuk do të pranohen nga AK.

– Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në kuti.

Mos-dorëzimi i mostrave në momentin e hapjes së ofertave ose mospërputhja e mallrave të ofruara me mostrat e paraqitura, është kusht për s’kualifikim. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të s’kualifikohet.

Mos-dorëzimi i mostrave në momentin e hapjes së ofertave ose mospërputhja e mallrave të ofruara me mostrat e paraqitura, është kusht për s’kualifikim. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të s’kualifikohet.”

OE nuk është paraqitur në ditën e hapjes së ofertave për paraqitjen e mostrave për çdo tip produkti të kërkuar nga AK.

b) Nuk përmbush: elementin në kriteret e përgjithshme të procedurës, lidhur me gjuhën e dokumenteve të paraqitura sipas paragrafit:

“Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.”

Konkretisht dokumentacioni teknik është paraqitur në gjuhë të huaj, i pa shoqëruar nga një përkthim i noterizuar në shqip.

c) Nuk përmbush piken 2.1 a) 1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8; si dhe piken 2.1 ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

OE nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.

d) Nuk përmbush : piken 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera mesatare e së cilës, të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së llogaritur të kontratës.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilanceve për vitet (2021-2022-2023) të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit

nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e tre viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

OE nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare...

e) Nuk përmbush piken 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2021-2022-2023) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlera totale e të cilave duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë këtyre tre viteve.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OE nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.

f) Nuk përmbush piken 2.3.6 Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentin e titulluar Ofertë Teknike i paraqitur nga AK në formën e një tablele (pjesë e dokumentacionit të specifikimeve teknike), kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë listën e artikujve që kërkohen. Dokumenti Ofertë Teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- Nr. i artikullit
- Emërtimi i artikullit
- Emri i kompanisë prodhuese
- Emri i katalogut
- Kodi i artikullit ose numri i faqes në katalog ose
- Dokumente të noterizuar

OE nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.

g) Nuk përmbush piken 2.3.7 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një Deklaratë që merr përsipër transportin dhe lëvrimin e mallrave drejt ambienteve magazinuese të Autoritetit Kontraktor.

OE nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP shpk, me adresë: “Tiranë Tiranë TIRANË, Rruga Reshit Çollaku, pallati i ri tek Tregu Çam, Kati i parë, Njësia Administrative nr.10”, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **32 956 616** (tridhjetë e dy milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) Lekë, **pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha*, me adresë: *Lagjja: “Brigada XVII Sulmuese”, Rruga: “Petraq Popa”, Elbasan*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO **JO x**

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ADMINISTRATORI